REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.2557/1 Prot.

Lushnje, më 19/03/2025

**PROJEKT-VENDIM**
Nr. 32
**KËSHILLIT BASHKIAK**

**MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2025**
**( Miratuar me VKB nr.112 datë 26.12.2024 )**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/____/ 2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Mbi një shtesë nga të ardhurat e trashëguara në Buxhetin e Vitit 2025", mbështetur në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 germa dh, në Ligjin Nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Ligjin nr.9936 date 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar.

**PROPOZOJMË:**

1. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 1,200,000 lekë.
2. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 1,200,000 lekë.

Rritja do të shkojë në:

a) Në **Bashkinë Lushnje** në programin AD129 "Zhvillim bujqesor, Ekonomik dhe Social" (00-01-AD129-606) për 1,200,000 lekë, "Familje ne nevoje te subvencionuar per qerate"

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financë-Buxhetit .
4. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**DREJTORIA FINANCË –BUXHETIT**
**Ervisa ÇUKO**

**DREJTORIA JURIDIKE**
**Bedri HIDA**

**KRYETAR I BASHKISË**
**Eriselda SEFA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

*Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes* *Tel:+355 35 222139* *E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com*